

RIMËKËMBJE, GJITHPËRFSHIRJE, QËNDRUESHMËRI

Buletini nr. 11 —————>

QERSHOR 2022



RINGJALLJE

INVESTIM

MBËSHTETJE

QËNDRUESHMËRI

KOORDINIM

PUNËSIM

MIRËQENIE

BARAZI

JETËSIM

EKONOMI

Për buletinin

INDEP për më shumë se njëmbëdhjetë muaj po monitoron dhe analizon zbatimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike në Kosovë. Informatat e nxjerra nga ky proces monitorimi, paraqiten përmes buletineve, analizave dhe raporteve të monitorimit. Këto të dhëna publikohen në mënyrë që çdo herë e më shumë publiku i gjerë të jetë i informuar rreth zbatimit të kësaj pakoje, si dhe të jetë i informuar rreth mundësive që këto masat të ndihmojnë në rimëkëmbjen e sektorëve të cilët Qeveria e Kosovës i ka konsideruar si më të prekurit nga pandemia COVID-19 e cila ka prekur gjithë botën.

Përmes edicionit të njëmbëdhjetë të buletinit, janë paraqitur analiza rreth rimëkëmbjes së gjelbër në Kosovë, karakteristikave që ka pasur Pako e Ringjalljes si dhe efektit të masave që kjo pako ka përfshirë. Ndër këto masa, vlenë të theksohet se jo të gjitha kanë gjetur zbatim të duhur dhe se pritet që të vihen në zbatim të tërësishëm gjatë periudhës së mbetur të zbatimit të pakos. Kjo për faktin se zbatimi i këtyre masave do të ofronte ndihmë dhe lehtësim të problemeve për qytetarët dhe bizneset e vendit tonë.

A KEMI PASUR RIMËKËMBJE TË GJELBËR NË KOSOVË?

Pandemia do të lë gjurmë edhe pas përfundimit të saj. Pasojat shëndetësore, ekonomike dhe zhvillimore vërehen edhe tani. Por përmirësimi i kësaj gjendjeje do të kërkojë kohë për t'u kthyer në normalitet. Paketë stimuluese që janë implementuar deri më tani janë forcë shtytëse drejt rimëkëmbjes, por këto pako nuk janë të mjaftueshme për krijimin e një zhvillimi të qëndrueshëm. Po ashtu ndikimi i tyre nuk mund të sigurojë që rimëkëmbja do të jetë e suksesshme në aspekt të zhvillimit ekonomik dhe qëndrueshmërisë në shumë sfera të jetesës.

Rimëkëmbja e qëndrueshme kërkon ndërhyrjen e politikave në shumë fusha zhvillimore, e jo vetëm stimulim fiskal për tejkalimin e përkohshëm të krizave dhe vështirësive. Politikat dhe përgjigjet ndaj rimëkëmbjes duhet të jenë të gjera në aspektin e gjithëpërfshirjes, zhvillimit ekonomik, krijimit të vendeve të reja të punës dhe në shumë sfera të tjera. Në këtë mënyrë, paketë e rimëkëmbjes duhet të bazohen në parimin e zhvillimit produktiv. Politikat e zhvillimit produktiv mund të përkufizohen gjerësisht si politika që synojnë të forcojnë strukturën prodhuese të një ekonomie të caktuar kombëtare, përmes krijimit të vendeve të punës, zhvillimit ekonomik, forcimit të stabilitetit dhe arritjes së qëndrueshmërisë afatgjate.

Një ndër aspektet kryesore që duhet të merret parasysh në paketë e rimëkëmbjes nga pandemia COVID-19 është përmirësimi afatgjatë ekonomik dhe fizik i ndryshimeve klimatike dhe angazhimi i vazhdueshëm ndaj arritjes së emetimeve sa më të ulëta të karbonit. Sipas raporteve dhe matjeve, gjatë pandemisë dhe izolimit si masë ndaj parandalimit të përhapjes së mëtutjeshme të pandemisë, emetimet ditore globale të gazrave serrë u zvogëluan për 17% në prill të vitit 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Këto shifra tregojnë se sa shumë shtrihet ndikimi nga aktivitetet e përditshme në aspektin mjedisor të globit. E me rifillimin e aktiviteteve ekonomike dhe kthimin dalëngadalë në normalitet, emetimet e gazrave serrë mund edhe të tejkalojnë shifrat paraprake.

Nevoja për të miratuar politika dhe rimëkëmbje me karbon të ulët dhe në hap pozitiv me ndikimet klimatike është thelbësore. Nëse përmes pakove financohen dhe shtyhen përpara projekte të gjelbërta, atëherë mund të arrijmë fitorë të dyfishtë, pra duke arritur rimëkëmbje ekonomike dhe tejkalim të vështirësive nga pandemia COVID-19, e në anën tjetër duke arritur synimet e emetimit të ulët të gazrave serrë. Promovimi i tranzicionit të energjisë, ku përfshihen projekte të

reja të gjenerimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme do të sjellte mundësi për vende të reja të punës, do të ndihmonte uljen e nivelit të emetimit të gazrave serrë, e gjithashtu do të ndihmonte rimëkëmbjen e cila do të ishte e gjelbërt dhe efikase.

Në Kosovë, për gjatë periudhës 27 mujore që nga infektimi i personave të parë me COVID-19, nuk ka pasur pako të cilat kanë qenë të bazuara në rimëkëmbje të gjelbër. Kjo për faktin që masat e përfshira në pakot stimuluese kanë qenë të karakterit social, duke ofruar para dhe formalizim, e duke mos krijuar vende të reja të punës përmes masave të cilat përmbajnë politika të gjelbra. Efektet disa dimensionale të pakove të gjelbra janë:

- Përmirësimi i zhvillimit ekonomik
- Krijimi i vendeve të reja të punës
- Reduktimi i emetimeve të gazrave serrë

Efektet e tilla do të mundësonin qëndrueshmëri më të gjatë, stabilitet dhe vende të reja të punës, krahas rimëkëmbjes nga pandemia dhe tejkalimit të krizës.

Pakoja e Ringjalljes Ekonomike iniciuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në thelb është e ngjashme me pako ekonomike të vendeve të ndryshme të botës dhe atyre evropiane. Në fakt, Republika e Kosovës, pavarësisht ekonomisë së saj të dobët, kishte prezantuar një pako të mirë-financuar, bazuar në vlerat e zotuara. Republika e Kosovës mban vendin e nëntë në mesin e 46 vendeve evropiane, për nga vlera e pakos së rimëkëmbjes ekonomike si përqindje e BPV të vitit 2019. Në qershor 2021, ecuria e mbështetjes ekonomike dhe sociale vazhdon në trajtën e Pakos së Ringjalljes Ekonomike dhe në vlerë 420 milionë €, dhe e strukturuar nëpërmjet pesë masave që për synim kanë përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe sociale. Republika e Kosovës ka prezantuar masa të ndryshme në të gjitha fushat ekonomike në të njëjtën frymë me vende të tjera, madje duke hedhur edhe një hap më tej, kur bie fjala për vlerat e zotuara.

Kosova nuk ka ndjekur parimet e rimëkëmbjes së gjelbër. Burimet e ripërtëritshme nuk janë përkrahur në Pakon e Ringjalljes duke mos u bërë asnjë investim në këtë sektor, e gjithashtu as në shtimin e masave të efijencës së energjisë. Mbështetja për disa muaj, siç është praktikuar përmes masave të kësaj pakaje, ka ndikuar vetëm në lehtësimin e disa problemeve, por jo edhe në tejkalimin e tyre. Një gjë e tillë nuk krijon qëndrueshmëri afatgjate, nuk ndihmon tranzicionin energjetik dhe nuk krijon vende të reja të punës. Marrë për bazë këtë, Kosova nuk ka shfrytëzuar mundësinë që rimëkëmbjen të e kthejë në stabilitet dhe vënjë të bazës së zhvillimit ekonomik për vitet e ardhshme.





KARAKTERISTIKAT E PAKOS SË RINGJALLJES EKONOMIKE

Rimëkëmbja e gjelbër nuk ka qenë bazë e rimëkëmbjes në Kosovë. Kanë munguar dhe tashmë edhe në Pakon e Ringjalljes Ekonomike po mungojnë masa të cilat ndërlidhen me krijimin e resurseve të reja të gjenerimit të energjisë elektrike përmes burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Zingjiri i krijimit të këtyre resurseve ndërlidhet me disa faktorë shumë të rëndësishëm, siç janë krijimi i vendeve të reja të punës, tejkalimi i krizës, zhvillimi ekonomik dhe shtyrja përpara e procesit të tranzicionit energjetik. Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë një zhvendosje serioze drejt një të ardhme të gjelbër dhe të qëndrueshme përmes hartimit dhe planit të Pakove Ekonomike të zgjeruar duke përfshirë mekanizmat e stimulimit të gjelbër.

Qeveria e Kosovës nuk po ndërmerr masa për transformimin e sektorit të energjisë. Mundësia e rimëkëmbjes nga pandemia COVID-19 përmes rimëkëmbjes së gjelbër është adekuate dhe profitabile. Përpos diversifikimit të burimeve të energjisë dhe shtimit të tyre, do të arrihej zhvillim ekonomik më i pastër dhe me perspektivë më të madhe se sa që është tani. Ky punim ka shpërfaqur shembuj tek të cilat Qeveria e Kosovës do të mund të bazohet dhe përmes tyre të hartojë pakot pasuese të cilat sigurisht se duhet të fokusohen tek rimëkëmbja e gjelbër, e jo vetëm në politikat e tejkalimit të krizës ekonomike aktuale.

Pako e Ringjalljes Ekonomike ka pasur në vete masa të cilat janë karakterizuar si lehtësime disa mujore dhe jo si bazë për rimëkëmbje të qëndrueshme. Një gjë e tillë ka ndikuar që kjo pako të mos ofrojë zgjidhje ndaj problemeve dhe vështirësive që pandemia COVID-19 ka sjellur në Kosovë. Duke ditur që ndikimet ekonomike të kësaj pakoje janë të vogla në ekonominë kosovare, kjo ka bërë që pako si e tillë të mos ofrojë rimëkëmbje adekuate.



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME →

- Rimëkëmbja e gjelbër nuk ka qenë bazë e rimëkëmbjes në Kosovë. Kanë munguar dhe tashmë edhe në Pakon e Ringjalljes Ekonomike po mungojnë masa të cilat ndërlidhen me krijimin e resurseve të reja të gjenerimit të energjisë elektrike përmes burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Zingjiri i krijimit të këtyre resurseve ndërlidhet me disa faktorë shumë të rëndësishëm, siç janë krijimi i vendeve të reja të punës, tejkalimi i krizës, zhvillimi ekonomik dhe shtyrja përpara e procesit të tranzicionit energjetik. Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë një zhvendosje serioze drejt një të ardhme të gjelbër dhe të qëndrueshme përmes hartimit dhe planit të Pakove Ekonomike të zgjeruar duke përfshirë mekanizmat e stimulimit të gjelbër.
- Të bëhet vlerësimi i masave të pakove paraprake dhe masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Vlerësimi i ndikimit të këtyre masave ndihmon në hartimin e masave të pakove të ardhshme, në mënyrë që të mos ketë dështime në mbështetje për qytetarët. Vendosja e standardeve për secilën masë përmes procesit të vlerësimit të tyre ndihmon në arritjen e tejkalimit të vështirësive të shkaktuara nga pandemia COVID-19.
- Qeveria e Republikës së Kosovës, duhet të bashkëpunoj me të gjitha palët e interesit. Komunikimi me palët e interesit krijon një platformë prej nga mund të krijohen ide dhe shkëmbehen përvoja për një implementim sa më të efektshëm të masave të pakos. Është poashtu shumë me rëndësi komunikimi me biznese, përfaqësues të grupeve të targetuara, OJQ dhe subjekte tjera përfituese nga masat e pakos, për të marrë informata në lidhje me efektet e masave. Një hulumtim i efekteve të masave, do të mundësonte që qeveria të identifikoj masat me frytëdhënëse dhe kanalizoj më shumë resurse financiare në masa të tilla.

- Pakot stimuluuese duhet të jenë në linjë me politika të gjelbra, të cilat sigurojnë zhvillim ekonomik të vendit. Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese përmes përdorimit të BRE-ve, shtimi i masave të efikasitetit të energjisë dhe shumë masa të tjera, do të krijojnë vende të reja të punës, do të shtynin përpara agjendën e gjelbër dhe do të kontribuonin në përmirësimin e mjedisit. Duke ditur benefitet dhe përparësitë që ka rimëkëmbja e gjelbër, e në anën tjetër duke ditur pozicionin që vendi ynë ka krahas Marrëveshjes së Gjelbër dhe Traktatit të Komunitetit të Energjisë, është e domosdoshme që të ndërmerim hapa të cilat stimulojnë ekonominë dhe arrijnë procese në të mirë të mjedisit.



“Ky projekt mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) një projekt i Fondit Gjerman Marshall të SHBA-ve dhe popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo opinionet e BTD, GMF, USAID ose Qeverisë së SHBA-së.”